



C.nr. 650/11

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, gjyqtari Enes Mehmeti, me sekretaren juridike Minire Krasniqi, në çështjen juridike të inicuar me padinë e paditësve: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], të dy nga fsh. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR] kundër të paditurve: [REDAKTUAR] më parë nga [REDAKTUAR] Rr. [REDAKTUAR] tani me adresë të panjohur, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] të dytë më parë nga [REDAKTUAR] Rr. [REDAKTUAR] tani me adresë të panjohur, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm, avokati [REDAKTUAR] nga Ferizaj për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, në seancën e mbajtur më datën 30.05.2017 ka marrë dhe publikuar këtë:

A K T G J Y K I M

- në bazë të pohimit -

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], nga fsh. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR] dhe **VËRTETOHET** se paditësit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] janë bashkëpronarë, secili me 1/2 të parcelës me nr. **286/1** në sipërfaqe prej **800m²** dhe parcelës nr. **286/2** në sipërfaqe prej **302m²** që gjenden në vendin e quajtur “Kodra e Madhe” Z.K. Varosh, K. Ferizaj.

II. OBLIGOHEN të paditurit: [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], që paditësve t’ua njohin të drejtën e pronësisë mbi këtë pronë dhe të durojnë regjistrimin e saj në regjistrat kadastral në emër të paditësve, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, në të kundërtën ky aktgjykim do t’i shërben paditësve si autorizim për të bërë regjistrimin e pronës në emër të tyre.

III. OBLIGOHEN paditësit që të bëjnë pagesën e taksës për aktgjykim në shumë prej 150€, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me forcë.

A r s y e t i m i

Paditësit kanë pretenduar me padi se në vitin 2006 e kanë blerë paluajtshmërinë nga të paditurit në bazë të kontratës së shitblerjes së datës 31.10.2006 dhe për të njejtën paluajtshmëri, në bazë të kësaj kontrate, e ka paguar në tërësi çmimin e shitblerjes në shumë totale prej 6.000 €. Pasi që të njejtit i kanë përmbushur në tërësi detyrimet lidhur me pagesën e çmimit, kanë marrë në posedim të papenguar pronën nga të paditurit. Paditësit nuk kanë mundur me kohë të vërtetojnë kontratën e shitblerjes në gjykatë, sepse autorizimet e dhëna nga të paditurit duhej të verifikoheshin nga gjykatat përkatëse në Serbi, në vendin ku janë lëshuar, dhe një verifikim i tillë deri më sot nuk ka ardhur nga organet e Serbisë, prandaj paditësit e kanë parë si zgjidhje të vetme që bartjen e pronësisë ta bëjnë përmes gjykatës në procedurë kontestimore.

Për të vërtetuar pretendimet e tyre, paditësit kanë propozuar një varg provash, si: kontratën e shitblerjes, të lidhur në mes paditësve dhe të paditurve, kopjen e autorizimeve të të paditurve, fletpagesën bankare dhe kanë propozuar që në cilësinë e dëshmitarëve të thirren: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], të dy nga fsh. [REDAKTUAR], K. [REDAKTUAR]

Gjykata, fillimisht, ka aprovuar propozimin e paditësve që të paditurve t'u caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, meqenëse të njejtit janë shpërngulur jashtë Kosovës menjëherë pas shitblerjes së kësaj paluajtshmërie, respektivisht në vitin 2006 dhe nuk ka asnjë kontakt apo informatë se ku mund të gjejnë adresën apo vend ndodhjen e tyre dhe të njejtëve me aktvendim u'a ka caktuar av. [REDAKTUAR] nga Ferizaj, si përfaqësues i përkohshëm i tyre.

Gjykata, aktvendimin për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm e ka publikuar në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve, Av. [REDAKTUAR] përmes përgjigjes në padi, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkespadinë e paditësve si të pabazuar për shkak se nuk ekziston asnjë argument apo arsye për njohje të pronësisë dhe se paditësit nuk posedojnë kontratë të shitblerjes së pronës së paluejtshme.

Gjatë seancës për shqyrtim kryesor të mbajtur më 11.04.2017 paditësit kanë deklaruar se mbeten në tërësi pranë theksimeve në padi dhe i propozojnë gjykatës që të bëhet dëgjimi i dëshmitarëve të propozuar, ndërsa përfaqësuesi i përkohshëm insitonte në pretendimet e dhëna në përgjigjen në padi. Gjatë seancës së mbajtur më 30.05.2017, si paditësit, ashtu edhe përfaqësuesi i përkohshëm janë pajtuar që gjykata ta bëjë administrimin e provave.

Dëshmitari i parë, [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR], deklaroi se në cilësinë e avokatit e kishte përpiluar kontratën e shitblerjes në mes të paditësve si blerës dhe të paditurve si shitës, dhe janë takuar në shtëpinë e nënës së të paditues së parë, [REDAKTUAR] e cila kishte nënshkruar në emrin e vet personal, dhe të dy të paditurve të tjerë [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] si shitës me autorizim dhënë të paditues së parë. Dëshmitari, mëtej shton se paditësit ia kanë paguar çmimin kontraktues personalisht [REDAKTUAR], e që gjatë dorëzimit të parave, prezent ishte edhe vëllau i [REDAKTUAR] pasi që ishim në shtëpin e tij gjatë dorëzimit të parave.

Dëshmitari i dytë, [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR], K. [REDAKTUAR], deklaron se ka qenë personalisht prezent në Shtërpcë, së bashku me paditësit dhe dëshmitarin e parë avokat [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] që ishte ndërmjetësues gjatë shitblerjes, ku i kam shoqëruar paditësit dhe e di se është bërë pagesa të paditues [REDAKTUAR] në emër të shitblerjes së tokës së.

Eksperti i gjeodezisë, gjeo. [REDAKTUAR], pas daljes dhe këqyrjes në vend, ka përpiluar raportin me shkrim të datës 14.04.2017, në të cilin ka deklaruar se: prona kontestuese gjendet në vendin e quajtur "Kodra e Madhe" Z.K. Varosh, K. Ferizaj, e ndarë në dy parcela: nr.286-1 me sipërfaqe prej 800m2 dhe parcela nr.286-2 me sipërfaqe prej 302m2 dhe shtrihen rreth rrugës magjistrale Prishtinë - Shkup, me kulturë livadh, që i përgjigjet masave dhe kufirit sipas planit

kadastral dhe fletës poseduese me pika kufitare të njejta. Sipas këtij raporti, parcelat kontestuese figurojnë në emër të dy paditësve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] me 2/6 të pjesës ideale të pronësisë dhe në emër të dy të paditurve [REDAKTUAR] me 1/6 të pjesës ideale dhe [REDAKTUAR] me 1/6 të pjesës ideale të pronësisë.

Në fjalën përfundimtare, paditësit mbeten pranë thënieve në padi dhe se edhe njëherë e deklarojnë se në këtë procedurë janë administruar provat materialenga të cilat vërtetohet themelsia e kërkesëpadisë, siç janë: kontrata e shitblerjes dhe autorizimet e dhëna për këtë shitblerje, dhe gjithashtu dëshmia e dëshmitarëve, avokat [REDAKTUAR] si hartues i kontratës së shitblerjes dhe dëshmitar i përmbushjes së kontratës, si dhe dëshmitari [REDAKTUAR], i cili deklaron se paditësit e mbajnë pronën e blerë në posedim dhe shfrytëzim të papenguar dhe me mirëbesim për më shumë se 10 vite. Prandaj, paditësit deklarojnë dhe i propozojnë gjykatës ta miratojë kërkesëpadinë e tyre në tërësi, si të bazuar.

Në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve, deklaron se në këtë çështje kontestuese u administruan provat materiale si dhe dëshmitë e dëshmitarëve, dhe gjithashtu është bërë identifikimi i saj me ekspert të gjeodezisë, nga të cilat konsiderojmë se është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, cila konsiston në atë se në mes të palëve ndërgjygjëse ka ekzistuar marrëveshja për shitblerjen e paluejtshmërisë objekt kontesti dhe se palët në tërësi i kanë përmbushur detyrimet reciproke, sa që 1/3 (pjesa ideale e pronësisë) e të paditësve [REDAKTUAR], tashmë është bartur në kadastër, mbi bazën e kontratës së njejtë, ndërsa ka ngelur për arsye formaliteti pa u bartur pjesa e të paditurve tjetërë, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]. Mëtej, ai deklaron se avokati [REDAKTUAR] është hartues i kësaj marrëveshje për shitblerje, prandaj i merr si të vërtetë deklaratat e tij, andaj mbi këtë bazë edhe i konsideron paditësit si pronarë të ligjshëm të pronës objekt kontesti i kësaj lënde.

Gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve si të pohuar duke qenë se në mes palëve ndërgjygjëse nuk ishin kontestuese faktet vendimtare të çështjes dhe se të paditurit respektivisht përfaqësuesi i përkohshëm i tyre shprehimisht ka pranuar kërkesëpadinë duke i pranuar faktet dhe provat e propozuara si të vërteta dhe në anën tjetër, gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes nuk ka gjetur ndonjë rrethanë, për të cilën duhet kujdesur kryesisht e cila do të pengonte aprovimin e kërkesëpadisë dhe rrethana tjera që t'i vënte në kundërshtim faktet dhe provat e çështjes me pohimin e kërkesëpadisë nga ana e përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit, ndaj në kuptim të nenit 148 të LPK-së, ka nxjerr aktgjykim në bazë të pohimit, *(në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimin në bazë të pohimit).*

Gjykata ka obliguar paditësin që të paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për aktgjykim në shume prej 50€, në bazë të nenit 445 të LPK-së.

Mbi bazën e parashtrimeve të mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr. 650/11, me datën 30.05.2017



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

